

AKT NORMATIV
Nr.5, datë 9.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9025, DATË 13.3.2003 “PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.1, DATË 9.3.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË HAPËSIRËS TOKËSORE, DETARE E AJRORE DHE DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË RAJONIN E GJIRIT PERSIK, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT””

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, dhe 101, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 2 të aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 9.3.2003 të Këshillit të Ministrave, miratuar me ligjin nr.9025, datë 13.3.2003, fjalët “... një kompani...” zëvendësohen me “...dy kompani...”.
Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha